

## PROJEKTILIGJI “PËR INVESTIMET”

**Komente dhe rekomandime**

## **Të përgjithshme**

Investimet nxisin rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe konkurrencën, dhe kështu zhvillimin ekonomik.

Bizneset dhe qeveritë në vendet në zhvillim, si dhe vendet e zhvilluara, janë shumë të vetëdijshme për rëndësinë e investimeve si nxitës të rritjes ekonomike. Bizneset, të mëdha dhe të vogla, e kuptojnë se investimi në nivel global është kritik për rritjen dhe konkurrencën. Ekonomitë e suksesshme në të gjitha nivelet e zhvillimit prirën të jenë ato që mirëpresin dhe tërheqin investitorët vendas dhe të huaj.

Investitorët e huaj kanë opsione të shumëfishta dhe do të kërkojnë mundësitë më të mira për investime, ato me perspektivat më të larta për kthimin e investimeve dhe me perceptimet më të ulëta të rrezikut.

Si rezultat, qeveritë gjithnjë e më shumë pranojnë se ekonomitë funksionojnë më mirë kur qeveria krijon një mjedis dhe infrastrukturë të përshtatshme, ndërkohë që sektori privat investon në sektorët prodhues.

## **Udhëzime të përgjithshme mbi kuadrin ligjor**

Vendi duhet të krijojë një klimë tërheqëse për investimet private, duke përfshirë edhe Investimet e Huaja Direkte. Nëse një vend dështon të miratojë politika të shëndosha pro-investuese rrezikon të mbetet pas në ekonominë globale konkurruese tani dhe në të ardhmen.

Kuadri ligjor mbi investimet në Shqipëri duhet:

- a. Të respektojë parimet e njohura të së drejtës ndërkombëtare, të pasqyruara në traktatet ndërkombëtare lidhur me trajtimin e pronës dhe investimet.
- b. Të ndërtojë dhe zbatojë një kuadër ligjor dhe rregulla që mundësojnë një mjedis të përshtatshëm për investimet e huaja dhe vendase, duke parashikuar në veçanti:
  - Trajtim të drejtë dhe të barabartë të investimit;
  - Shmangie e masave arbitrare, të paarsyeshme dhe diskriminuuese;
  - Respektim të kontratave dhe angazhimeve të tjera që i janë dhënë investitorit; dhe,
  - Në rastin e shpronësimit ose shtetëzimit, pagesën efektive të kompensimit të drejtë dhe pa vonesë.
- c. Të parashikojë dhe të zbatojë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përmes mekanizmave të detyrueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në veçanti përmes:
  - Qasjes së barabartë për investitorët e huaj për t’u gjykuar përpara një sistemi gjyqësor të pavarur në përputhje me sundimin e ligjit; dhe,
  - Njohjes së të drejtës për investitorët për të ndjekur arbitrazhin ndërkombëtar, për shembull sipas rregullave të Arbitrazhit të ICC-së, ose mekanizmave të tjerë të njohura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes investitorëve dhe shteteve.
- d. Të parashikojë në kuadrin ligjor kombëtar mbrojtjen e duhur për aksionerët e pakicës, në ato raste kur dispozitat përkatëse ende nuk ekzistojnë.
- e. Të sigurojë publikimin dhe transparencën e të gjitha ligjeve, rregulloreve dhe praktikave kombëtare në lidhje me investimet e huaja në kohën e duhur.

## KOMENTE DHE SUGJERIME

---

### ➤ Neni 6, Standardi minimal i trajtimit

#### Komente të përgjithshme

Përkufizimi për standardin “*trajtim i drejtë dhe i barabartë*” duhet konceptuar në një bazë më të gjerë bazuar edhe në konkluzionet apo afirmimet e themeluara nga jurisprudenca e arbitrazhit ndërkombëtar e frymëzuar nga vendimmarrja ICSID “Tribunals on state investor disputes”.

Formulimi konvencional i këtij standardi duke i dhënë edhe nuancat e jurisprudencës ndërkombëtare mund të ishte veçanërisht ndikues dhe orientues edhe në trajtimin e këtij standardi nga ana e gjykatave vendase apo arbitrazhit vendas nëse mosmarrëveshja përkatëse do t’i referohej këtyre.

Qartësimi i mëtejshëm i themeleve të standardit “*trajtim i drejtë dhe i barabartë*” duke shtuar edhe të drejtën e investitorit për një ankim efektiv përpara autoriteteve shtetërore dhe gjyqësore vendase.

#### **Pika 2**

Komente: Përkufizimi që jepet për standardin “*trajtim i drejtë dhe i barabartë*” është i përciptë, shumë i paqartë dhe jo i plotë. Përkufizimi lë hapësirë për një interpretim të dëmshëm të nocionit dhe frazës.

Përkufizimi “*...që nuk përbën shmangie të madhe nga parimet e së drejtës materiale dhe procedurale...*” nuk është orientues dhe paraqet mjaft paqartësi përmes frazave pa i specifikuar ato. I formuluar në këtë mënyrë siç është, ky përkufizim, nuk do të jetë i qartë për diskrecionin apo vlerësimin e autoriteteteve shtetërore dhe organeve të përcaktuara me ligj apo gjykatave vendase, nëse do të jetë rasti, për trajtimin e investimit qoftë vendas apo të huaj.

Sugjerim: Të fshihet dhe shmanget përkufizimi “*...të madhe...*” nga “*... që nuk përbën shmangie të madhe nga parimet e së drejtës materiale dhe procedurale...*”. Ky përkufizim nuk është në përputhje me praktikatat më të mira dhe traktatet ndërkombëtare.

Për më tepër standardi për “*një trajtim të drejtë dhe të barabartë*” nuk reflekton standardet bashkëkohore të trajtimit të tij nga tribunalet e ndryshme të ICSID që kanë krijuar një jurisprudencë më vete për trajtimin dhe adresimin e këtij standardi në mosmarrëveshjet shtet-investitor (state investor disputes).

Po kështu ky standard duhet përcaktuar qartë dhe për trajtimin e rasteve të tilla përpara gjykatave vendase nëse ato do të zgjidheshin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve bazuar në një kontratë ndërmjet autoritetit shtetëror dhe investitorit vendas/të huaj.

Sugjerim: Ne sugjerojmë formulimin e mëposhtëm të pikës 2:

*‘Trajtim i drejtë dhe i barabartë i investimit është trajtimi i tij nga ana e autoriteteve shtetërore dhe atyre gjyqësore në mënyrë jodiskriminuese dhe joarbitrare, në respektim të plotë të parimeve të së drejtës ndërkombëtare të njohura gjerësisht, të tilla si parimi i transparencës, mbrojtja e pritshmërive legjitime të investitorëve, procesi i rregullt ligjor dhe aksesimi ndaj drejtësisë.’*

### **Pika 3**

Sugjerim: Në pikën 3 të këtij Neni, në vijim të përkufizimit të mësipërm të sugjeruar, duhet domosdoshmërisht që investitorët jo vetëm të njoftohen dhe të ftohen të bëjnë komente përpara miratimit të vendimeve, por t’ju sigurohet "e drejta e një ankimi efektiv" pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse.

Mendojmë që në fjalinë e dytë të pikës 3 përveç dhënies së mundësisë së arsyeshme për t’u informuar dhe komentuar mbi masat, t’ju garantohet edhe e “drejta e një ankimi efektiv” përpara autoriteteve shtetërore përgjegjëse sipas këtij ligji.

#### **➔ Neni 10 ‘Transferimi i fondeve’**

Pika 1 e nenit 10 parashikon të drejtën e investitorëve për të transferuar lirshëm fitimet e tyre, megjithatë, pika 2 e këtij neni parashikon që Qeveria mund të imponojë kufizime për transferimin e fondeve në rast të vështirësive serioze në bilancin e pagesave ose të kërcënimit për vështirësi të tilla, me kusht që masat e tilla të jenë në përputhje me standardet e FMN-së, në mirëbesim dhe mbi baza jo diskriminuese.

Koment: Formulimi i mësipërm është shumë i përgjithshëm dhe i njeh kompetenca të gjera autoriteteve për të kufizuar investitorët për të transferuar fondet e tyre, të tilla si fitime, dividende etj.

Kjo formulim sipas Projektligjit do t’u mundësojë autoriteteve diskrecion në ushtrimin e pushtetit të tyre për të kufizuar transferimin e fondeve. Në përgjithësi, investitorët nuk duhet të kufizohen për të transferuar lirisht fondet e tyre të ligjshme, sipas gjykimit të tyre.

Sugjerim: Të rishikohet formulimi.

#### **➔ Neni 12 ‘Mbrojtja nga shpronësimi’**

Komente të përgjithshme:

Masa e kompensimit në raste të tilla, e cila në ligj është përcaktuar si “kompensim i duhur”, nuk duhet të gjejë strehë tek legjislacioni ynë i shpronësimit që është larg standardeve ndërkombëtare, por duhet të frymëzohet nga normat ndërkombëtare për një trajtim të tillë për “një kompensim të menjehershëm dhe të drejtë” (prompt and just compensation).

### **Pika 1**

*Koment:* Projektligji parashikon *"kompensim i duhur"* në rastin e shpronësimit, ndërkohë që çdo kompensim i tillë duhet të shoqërohet me pagesë të arsyeshme, efektive dhe të menjëhershme të tij. Ky parashikim nuk garanton në mënyrë të plotë mbrojtjen e investimit nga masat e shpronësimeve apo masat e barasvlefshme me to.

*Sugjerim:* Do të sugjeronim për rishikim të formulimit të kësaj pike të këtij neni me synim për afrimin me standardet ndërkombëtare të masës apo formulës së kompensimit.

Përkufizimi *"kompensim i duhur"* të zëvendësohet me *"kompensim të drejtë"*.

Pika 1 i nenit 12 duhet të përshkruajë qartë se shpronësimi është (i) për një qëllim që është në interes të qartë publik; (ii) nuk është diskriminues; (iii) kryhet sipas një procesi të rregullt ligjor; dhe (iv) shoqërohet me pagesë të arsyeshme, efektive dhe të menjëhershme të kompensimit.

*Koment:* Gjithashtu, përfshirja e ligjit organik të shpronësimeve në Republikën e Shqipërisë e kompromenton terësisht qëllimin e normës së mbrojtjes nga shpronësimet duke pasur në konsideratë parasysh mangësitë e ligjeve shqiptare mbi shpronësimet dhe praktikën e deritanishme e cila nuk arrin asnjë standard ndërkombëtar të afirmuar apo të njohur.

*Sugjerim:* Për rrjedhojë do të sugjeronim që përkufizimi *"ligji organik për shpronësimet në RSH"* të hiqet.

Ky përkufizim të zëvendësohet me *'në përputhje me standardet dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të njohura dhe pranuar gjerësisht'*.

### **Pika 3**

*Koment:* Pika 3 e nenit 12 parashikon që *'... kompensimi do të bazohet në vlerën e tregut përpara shpronësimit'*, i cili nuk është në përputhje me parashikimin ndërkombëtar.

*Sugjerim:* Sugjerojmë referimin sipas standardeve ndërkombëtare. Standardi ndërkombëtar parashikon *'vlerën e tregut menjëherë përpara kompensimit'*. Një datë e tillë duhet të përkufizohet si *"Data e Vlerësimit"*.

*Koment:* Në të njëjtën pikë të këtij neni përkufizohet se *'Kompensimi do të përfshijë interesin me një normë tregtare të arsyeshme për atë monedhë që nga data e shpronësimit deri në datën e pagesës'*.

*Sugjerim:* Praktika më e mirë ndërkombëtare sipas traktateve ndërkombëtare parashikon *'normën tregtare të aplikuar mbi vlerën e tregut'*.

➤ **Neni 14 “Detyrimet e investitorit”**

*Sugjerim:* Rekomandojmë që në nenin 14, përkufizimi “Investitorët duhet të kryejnë çdo detyrë...” të hiqet dhe të mbetet vetëm “Investitorët duhet të përmbushin çdo detyrim që buron nga legjislacioni shqiptar në fuqi”.

➤ **Neni 23 “Komiteti për Investimet Strategjike”**

**Pika 1**

*Sugjerim:* Komiteti i Investimit Strategjik të jetë një organ kolegjal apolitik i përbërë nga personalitete të fushave të ndryshme që do të konsultojë dhe sugjerojë vendimmarrjen përfundimtare ndaj Zyrës së Kryeministrit, Ministrit përkatës dhe kryetarit të bashkisë përkatëse në territorin e së cilës pritet të realizohet investimi strategjik.

➤ **Neni 26 “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve shtet-investitor”**

**Pika 1**

*Sugjerim:* Sugjerojmë që përkufizimi “kapitalin e investuar” të zëvendësohet me “në lidhje me investimin”.

**Pika 2**

*Sugjerim:* Sugjerojmë që pika 2 e këtij neni të hiqet pasi nuk ka vlerë dhe të vazhdohet në mënyrë ezauresive me paragrafet vijuese të mekanizmit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, në kushtet ku mosmarrëveshja nuk është zgjidhur me mirëkuptim ndërmjet palëve.

**Pika 3**

*Sugjerim:* Pas frazës “...juridiksionin ekskluziv të Gjykatave të Republikës së Shqipërisë...” të shtohet sipas ‘përcaktimeve të Ligjit “Për të Drejtën Ndërkombëtare Private”’.

**Paragrafi 3/a**

*Sugjerim:* Sugjerojmë heqjen e arbitrazhit *ad hoc* sikurse propozohet në bazë të UNCITRAL Rules dhe të zëvendësohet me arbitrazh institucional siç është ‘Rregullat e Arbitrazhit të ICC Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë’. Në këtë nen ofrohen si alternativë përzgjedhja midis dy institucioneve të njohura mndërkombëtarisht dhe mjaft të rëndësishme në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve shtet-investitor: ICC ose ICSID në varësi të përzgjedhjes së palës që nis procesin.

Integrimi i klauzolave të arbitrazhit institucional në një ligj që synon mbrojtjen e investitorëve të huaj ekspozon garanci dhe kredibilitet të shtuar në sytë e këtyre investitorëve në raport me alternativën e arbitrazhit *ad hoc* siç është në përmbajtjen ekzistuese, për arsytet e mëposhtme:

## *Komente mbi projektligjin ‘Për Investimet’*

- › Cilësia, reputacioni dhe mundësia pothuajse automatike e zbatimit të vendimeve përfundimtare që prodhojnë këto institucione si ICC dhe ICSID është tashmë e afirmuar, në çdo sistem ligjor apo juridiksion mbarëbotëror në raport me arbitrazhet *ad hoc*.
- › Rregullat, praktikat dhe prestigji i këtyre institucioneve shkon kah pritshmërive të investitorëve të huaj për një proces sa më efektiv dhe të besueshëm larg ndikimit të gjykatave lokale. Gjithashtu, për shkak të kontrollit institucional që ICC dhe ICSID ushtrojnë ndaj vendimmarrjes së tribunaleve, garantohen produkte përfundimtare që njihen dhe zbatohen efektivisht pranë gjykatave lokale.
- › Në ndryshim me arbitrazhin *ad hoc*, arbitrazh institucional i ICC ofron shërbime të posaçme administrative, nëse palët bien dakord, për emërimin e arbitrave me personalitete dhe posaçërisht të specializuar në sferën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të investimeve apo konflikteve Shtet - Investitor i huaj.